

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DIBËR
Nr. 125 dt 06.02.24



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

462
Nr. _____ Prot

Peshkopi, më 05.02.2024

Lënda: Dërgim vendimi

Drejtuar: Prefekti i Qarkut Dibër

Bashkëngjitur po ju dërgojmë për konfirmim Vendimin e Këshillit Bashkiak Dibër Nr.02

Datë: 31.01.2024

“Mbi miratimin e kritereve për familjet në nevojë që do të trajtohen me fondin deri në
6 % për vitin 2024”

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

Sekretari i Këshillit Bashkiak



Ilir Elezi



402/07/02/24

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DIBËR

Nr.125/1 prot.

Peshkopi, më 06.02.2024

Lënda: Për vendimin nr.02, datë 31.01.2024 të Këshillit të Bashkisë Dibër.

BASHKISË DIBËR


DIBËR

Në mbështetje të ligjit nr.107/2016, date 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", neni 16, pasi verifikova për efekt ligjshmërie vendimin e Këshillit të Bashkisë Dibër nr.02, datë 31.01.2024 "Mbi miratimin e kritereve për familjet në nevojë që do të trajtohen me fondin deri në 6% për vitin 2024", vendosa:

Miratimin në parim të vendimit objekt verifikimi dhe shqyrtimi në kushtet e zbatimit të legjislacionit aktual që rregullon marrëdhëniet juridike në fushën përkatëse nën përgjegjësinë direkte administrativo-ligjore të strukturave të posaçme të Bashkisë Dibër, që paraqesin për miratim projekt akte të kësaj natyre.

PREFEKTI

Nexhbedin SHEHU





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

VENDIM

Nr. 02 Datë 31 / 01 /2024

“Mbi miratimin e kriterëve për familjet në nevojë që do të trajtohen me fondin deri në 6 % për vitin 2024”.


Në zbatim Ligjit 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, të Ligjit 109/2017 “Për Buxhetin e vitit 2018”, të Ligjit 9355 date 10.03.2005 “Për Ndhimën dhe Shërbimet Shoqërore” i ndryshuar, të Vendimit nr.597, date 4.9.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për Përcaktimin e Procedurave, Dokumentacionit dhe të Masës Mujore të Përfitimit të Ndhimës Ekonomike dhe Përdorimit të Fondit Shtesë mbi Fondin e Kushtëzuar për Ndhimën Ekonomike” si dhe Udhëzim nr.5 datë 17.02.2017 “Mbi Përdorimin e Fondit të Kushtëzuar për Bllok-Ndhimën Ekonomike deri në 6 %”, Pika 1; 2; 4; 6, Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës 31.01.2024 me 23 vota pro, 0 kundër dhe 0 apstenim:

VENDOSI:

Familjet të cilat, nuk janë shpallur përfituese nga sistemi i pikëzimit, që të përfitojnë nga ndihmë ekonomike, duke përdorur Fondin 6%, duhet të plotësojnë disa kriterë:

Të përfitojnë familjet aplikuese të cilat plotësojnë këto kriterë:

1. Familje me një prind, (nga humbja e bashkëshortit/es; divorci, lidhje jashtëmartesore) ku përparësi të kenë gratë kryefamiljare. Këto familje do të përzgjidhen sipas vlerësimit si dhe numrit të anëtarëve të familjes (psh përfiton ajo familje e cila ka më shumë anëtarë).
2. Familje me 1 anëtar në kushte të vështira ekonomike, (të vetmuar, të divorcuar).
3. Familjet “Vajzë nënë” të cilat, nuk janë shpallur përfituese nga sistemi i pikëzimit.
4. Familjet me probleme të dhunës në familje, (për shkaqe të ndryshme).
5. Familje të cilat kanë në përbërje persona me probleme shëndetësore të cilët janë të paaftë për të punuar.
6. Familje që kanë në përbërje të tyre anëtarë mbi moshë pune në kushte të vështira ekonomike.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
DREJTORIA E KUJDESIT SOCIAL
SEKTORI I KUJDESIT SOCIAL

PROJEKT-VENDIM

Nr. 01 datë 22/01/2024

“PËR PROPOZIM PËR DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE PËR MUAJIN DHJETOR 2023, FAMILJEVE NË NEVOJË QË JANË PËRJASHTUAR NGA SISTEMI PËR ARSYE TË PIKËZIMIT, DUKE PËRDORUR FONDIN E KUSHTËZUAR PËR BLOK-NDIHMËN EKONOMIKE DERI NË 6 PËRQIND, I NDRYSHUAR”

Në mbështetje të nenit 21, të ligjit nr.9355, datë 10.03.2005 dhe VKM 957, Date 04.09.2019, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar, të Kreut IV, pika 2 të vendimit nr 955, date 07.12.2016, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike”, të ndryshuar dhe Udhëzimit nr.5, datë 17.02.2017 “Mbi përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6 përqind”, i ndryshuar dhe në Udhëzimin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr 1190/1 prot, datë 23.02.2018 “Për përdorimin e fondit deri në 6%”.

Struktura përgjegjëse për shërbimet sociale pranë Bashkisë Dibër:

I propozon Këshillit të Bashkisë Dibër dhëniën e ndihmës ekonomike për muajin Dhjetor 2023, 439 familjeve në nevojë, të cilat janë aplikuese në sistemin e ndihmës ekonomike, por nuk janë shpallur fituese për muajin Dhjetor për arsye të pikëzimit.

Këto familje janë të përzgjedhura nga njësitë administrative sipas kriterëve të përcaktuara.

I bashkangjitet këtij Projekt-Vendimi lista emërore me shumën përkatëse sipas Njësie Administrative.

Përgjegjës i Kujdesit Social

Elson Murrja

Drejtori i Kujdesit Social

Ardit Hoxha

KRYETARI I BASHKISË

Rahim SPAHIU

NË MUNGESË DHE ME AUTORIZIM

ZV/KRYETARI

Ruzhdi DEDA

Drejtori Juridik

Ismet Saraçi



REPUBLIKA E SHQIPËRIË
BASHKIA DIBËR
DREJTORIA E KUJDESIT SOCIAL
SEKTORI I KUJDESIT SOCIAL

PROJEKT-VENDIM

Nr. 02 datë 22/01/2024

**Mbi miratimin e kriterëve për familjet në nevojë që do të trajtohen me fondin deri në
6 % për vitin 2024**

Në zbatim Ligjit 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", të Ligjit 109/2017 "Për Buxhetin e vitit 2018", të Ligjit 9355 date 10.03.2005 "Për Ndihmën dhe Shërbimet Shoqërore" i ndryshuar, të Vendimit nr.597, date 4.9.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për Përcaktimin e Procedurave, Dokumentacionit dhe të Masës Mujore të Përfitimit të Ndihmës Ekonomike dhe Përdorimit të Fondit Shtesë mbi Fondin e Kushtëzuar për Ndihmën Ekonomike" si dhe Udhëzim nr.5 datë 17.02.2017 "Mbi Përdorimin e Fondit të Kushtëzuar për Bllok-Ndihmën Ekonomike deri në 6 %", Pika 1; 2; 4; 6, i propozojmë Këshillit Bashkiak Dibër sa më poshtë:

Familjet të cilat, nuk janë shpallur përfituese nga sistemi i pikëzimit, që të përfitojnë nga ndihmë ekonomike, duke përdorur Fondin 6%, duhet të plotësojnë disa kriterë:


Të përfitojnë familjet aplikuese të cilat plotësojnë këto kriterë:

1. Familje me një prind, (nga humbja e bashkëshortit/es; divorci, lidhje jashtëmartesore) ku përparësi të kenë gratë kryefamiljare. Këto familje do të përzgjidhen sipas vlerësimit si dhe numrit të anëtarëve të familjes (psh përfiton ajo familje e cila ka më shumë anëtarë).
2. Familje me 1 anëtar në kushte të vështira ekonomike, (të vetmuar, të divorcuar).
3. Familjet "Vajzë nënë" të cilat, nuk janë shpallur përfituese nga sistemi i pikëzimit.
4. Familjet me probleme të dhunës në familje, (për shkaqe të ndryshme).
5. Familje të cilat kanë në përbërje persona me probleme shëndetësore të cilët janë të paafhtë për të punuar.
6. Familje që kanë në përbërje të tyre anëtarë mbi moshë pune në kushte të vështira ekonomike.

7. Familje të cilat kanë në përbërje fëmijë të cilët kanë lindur më shumë se dy njëherësh.
8. Familje me më shumë se 5 anëtarë në kushte të vështira ekonomike.
9. Familjet që do të përzgjidhen duhet të jenë detyrimisht në listën e familjeve që kanë aplikuar Brenda 3 (tre) muajve të fundit në regjistrin elektronik për ndihmë ekonomike por që nuk janë shpallur përfitues nga sistemi i pikëzimit.
10. Për familjet që do t'i propozohen Këshillit të Bashkisë për miratim, duhet detyrimisht të jetë kryer paraprakisht vlerësimi social ekonomik në familje nga administrator shoqëror i Njësisë Administrative të cilës i përket, sipas Vendimit nr. 597, datë 04.09.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për Përcaktimin e Procedurave, Dokumentacionit dhe të Masës Mujore të Përfitimit të Ndhmës Ekonomike dhe Përdorimit të Fondit Shtesë mbi Fondin e Kushtëzuar për Ndhmën Ekonomike".
11. Në bazë të propozimeve të ardhura nga Njësitë Administrative për trajtim me ndihmë ekonomike në masën e kushtëzuar deri në 6%, Struktura përgjegjëse për shërbimet sociale në Bashki harton projektvendimin përkatës për familjet në nevojë që përfitojnë nga kjo skemë dhe miratohet në Këshillin e Bashkisë.
12. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Njësitë Administrative, Drejtoria e Kujdesit Social dhe Sektori i Kujdesit Social.
13. Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit nga Prefekti.

Përgjegjës i Kujdesit Social

Elson Murrja



Drejtori i Kujdesit Social

Ardit Hoxha



KRYETARI I BASHKISË

Rahim SPAHIU

Drejtori Juridik



Ismet Saraçi



NË MUNGESË DHE ME AUTORIZIM

ZV/KRYETARI

Ruzhdi DEDA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
DREJTORIA E KUJDESIT SOCIAL
SEKTORI I KUJDESIT SOCIAL

RELACION

“Mbi miratimin e kriterëve për familjet në nevojë që do të trajtohen me fondin deri në 6 % për vitin 2024”

Në zbatim Ligjit 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, të Ligjit 109/2017 “Për Buxhetin e vitit 2018”, të Ligjit 9355 date 10.03.2005 “Për Ndhimën dhe Shërbimet Shoqërore” i ndryshuar, të vendimit nr. 597, datë 04.09.2019, “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike” si dhe Udhëzim nr.5 datë 17.02.2017 “Mbi Përdorimin e Fondit të Kushtëzuar për Bllok-Ndhimën Ekonomike deri në 6 %”, Pika 1; 2; 4; 6, Sektori i Kujdesit Social, i parashtron Këshillit Bashkiak relacionin si më poshtë vijon:

Mbështetur në nenin 21, të ligjit nr. 57/2019, “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, përcaktohet se Këshilli Bashkiak miraton kriteret për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet aplikuese, të cilat nuk janë shpallur përfituese nga sistemi i pikëzimit, bazuar në vlerësimin social-ekonomik të kryer nga administratori shoqëror. Familjet në nevojë trajtohen nga fondi shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike, duke përfshirë ose jo edhe fonde të buxhetit vendor. Përdorimi i fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave, si dhe Udhëzim nr.5 datë 17.02.2017 “Mbi Përdorimin e Fondit të Kushtëzuar për Bllok-Ndhimën Ekonomike deri në 6 %”, Pika 4, përcaktohet se Këshilli i Bashkisë miraton në fillim të vitit kriteret për familjet në nevojë që do të trajtohen me fondin deri në 6 %.

Në zbatim, Këshilli i Ministrave ka miratuar edhe vendimin nr. 597, datë 04.09.2019, “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike” dhe ku në Kreun IV, pika 1, të të cilit parashikohet se këshilli bashkiak miraton në fillim të vitit kriteret për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet aplikuese për ndihmë ekonomike, të cilat nuk janë shpallur përfituese nga sistemi i pikëzimit dhe që do të trajtohen me fondin shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike.

Në vijim, pikat 2 dhe 3, të këtij vendimi, parashikojnë se Këshilli Bashkiak ka të drejtë të miratojë dhënien e ndihmës ekonomike për familjet aplikuese, të cilat nuk janë shpallur përfituese nga sistemi i pikëzimit, duke përdorur fondin shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike.

Kriteret mbi përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok ndihmën ekonomike deri në 6%, propozojmë të jenë:

1. Familje me një prind, (nga humbja e bashkëshortit/es; divorci, lidhje jashtëmartesore) ku përparësi të kenë gratë kryefamiljare. Këto familje do të përzgjidhen sipas vlerësimit si dhe numrit të anëtarëve të familjes (psh përfiton ajo familje e cila ka më shumë anëtarë).

2. Familje me 1 anëtar në kushte të vështira ekonomike, (të vetmuar, të divorcuar).
3. Familjet "Vajzë nënë" të cilat, nuk janë shpallur përfituese nga sistemi i pikëzimit.
4. Familjet me probleme të dhunës në familje, (për shkaqe të ndryshme).
5. Familje të cilat kanë në përbërje persona me probleme shëndetësore të cilët janë të paafte për të punuar.
6. Familje që kanë në përbërje të tyre anëtarë mbi moshë pune në kushte të vështira ekonomike.
7. Familje të cilat kanë në përbërje fëmijë të cilët kanë lindur më shumë se dy njëherësh.
8. Familje me më shumë se 5 anëtarë në kushte të vështira ekonomike.

Për familjet që do t'i propozohen Këshillit të Bashkisë për miratim, duhet detyrimisht të jetë kryer paraprakisht vlerësimi social ekonomik në familje nga administrator shoqëror i Njesisë Administrative të cilës i përket, sipas Vendimit nr.597, datë 04.09.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për Përcaktimin e Procedurave, Dokumentacionit dhe të Masës Mujore të Përfitimit të Ndhmës Ekonomike dhe Përdorimit të Fondit Shtesë mbi Fondin e Kushtëzuar për Ndhmën Ekonomike".

Sa më lart, i propozojmë Këshillit Bashkiak, në cilësinë e organit vendimmarrës, miratimin e kritereve për përdorimin e fondit të kushtëzuar mbi programin e bllok-ndihmës ekonomike deri në 6 %, për vitin 2024.

Duke shpresuar në miratimin e këtij materiali nga ana juaj,

Përgjegjës i Kujdesit Social

Elson Murrja



Drejtori i Kujdesit Social

Ardit Hoxha

